

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
“AlteaPharma 2013” SH.P.K**

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia



Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “AlteaPharma 2013” sh.p.k është themeluar në bazë të aktit të themelimit sipas Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014, datë 02.10.2014, si dhe në Ligjin 9723. Datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar me Ligjin Nr.9916, datë 12.05.2008, me Ligjin Nr.92/2012, datë 27.09.2012 dhe me Ligjin Nr.8/2015, datë 19.02.2015 dhe në përputhje me legjisacionin në fuqi.

Parashikimet e këtij Statutit zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K)

Në këtë Statut:

- Ligji është Ligji Nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014, datë 02.10.2014;
- “Statutit” është Statutti i Shoqërisë;
- QKB- Qëndra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

Sot, më 25 Mars ne themeluesit:

- Letter Ndrio, i biri i Caci-t , i datëlindjes 04.08.1948, lindur në Berat, dhe banues në Berat, Shqiperi ne adresen:Rruga Bauent Xhovan Doga, Pallati 240/1,H1,Ap.6 i pajisur me dokumentin e identitetit, kombetar karte id me Nr. E80804069V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepnuar, ne cilësinë e ortakut te shoqërisë “AlteaPharma 2013” sh.p.k.

**Neni 1
Emri dhe Forma Juridike**

- 1.1 Emri dhe emertimi tregtar i Shoqërisë është “AlteaPharma 2013” SH.P.K.
1.2 Emertimi tregtar i Shoqërisë është “Farmaci Redon”
1.3 Shoqëria “AlteaPharma 2013 ” Sh.p.k. është një person juridik privat, themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (me pas referuar si “Ligji”) në formën e shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar.
1.4 Shoqëria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qëndra Kombëtare te Biznesit (me pas referuar si “QKB”) në përpunje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Farmaci import eksport integrator ushqimor.parafarmaceutik dhe suplemente

**Neni 3
Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat te pacaktuar kohor.

Neni 4

 2

Selia, Adresa

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, Tirane, Njesia Administrative Nr.6, Rr.Tre Deshmoret nr.1
ndertese perdhese nr 66.
- 4.2 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është “nuk ka”.
- 4.3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon farmaciredon@hotmail.com Cel:+ 0699111103;

- 4.4 Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nepërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Neni 5

Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakeve.

- 5.1 Në rast vdekje apo falimenti, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakeve.
- 5.2 Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të ortakeve mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emr të një personi tjeter të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 6

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njeqind mijë) Lekë.
- 6.2 Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligji, me vendim te Ortakeve.

- 6.3 Kapitali fillestar i shoqerise “AlteaFarma 2013” Sh.p.k eshte 100.000 (njeqind mijë) leke.

- 6.4 Kapitali eshte i ndare ne një kuote te cilat Jane ne zoterimin e ortakeve si vijon:

- Lefer Ndrio zoterues e një kuote te kapitalit 100% me vlerë nominale 100.000 leke.(njeqind mijë)

- 6.5 Ortaket kane të drejtë te tjeterosojë këtë kapital, të shtojnë apo të pakesojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e percaktuara nga ligji.

- 6.6 Ortaket miratojne llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperreve kontabel te autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vittit finanziar, merr vendim per ndryshimet qe mund te pesoj statuti, per ndryshimin e mases se kapitalit themeltar dhe shdnerrimin e shoqerise ne nje forme tjeter, per punesimin e punonjesve dhe pagat, si dhe probleme te tjera te lidhura me punesimin ne zbatim te legjisacionit shqiptar etj. Vendimet e Ortakeve evidentohen ne nje regjister.

Neni 7

Kërkesa për të paguar kuotat dhe têrheqja e kuotave të papaguara

- 7.1 Administratori mund ti kërkojë ortakeve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera (në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njofitimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributive të papaguara.

- 7.2 Zotëruesi i kuotes do të jetë përgjegjës dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributive, sipas njoftimit të mësipërm.



Neni 8

Certifikatat e kuotave

8.1 Ortaket e shoqerise kanë të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tyre. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letërës me vlerë.

Neni 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

9.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

9.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

10.1 Ortakët, mund të zmadhojnë dhe te vendosin zgjelimin per kapitalin themeltar të shoqërisë duke ritur kuotat e veta përcaktuar në vendimin përkatës.

Neni 11

Hetimet e posacme

11.1 Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë riëpërmjet depozitimit të një deklarate notariale në selinë e shoqërisë e cilës vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu III

Administratori

Neni 12
Emërimi i Administratorit

- 12.1 Ortaket emërojnë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. A fati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 12.2 Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të Ligjit 9901, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Qdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 12.3 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërise.
- Administratori i pare i shoqerise caktohet z Redon Ndrio, i biri i Lester-it, i datëlindjes 22.06.1984, lindur në Berat, dhe banues në Tirane, Shqipëri ne adresen: Rruga Mikel Maruli, Pallati Pienvis h1 Kat 3 Ap.14 i pajuur me dokumentin e identitetit ,kombtar karte id me Nr. 1406220860, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e administratorit te shoqërisë “AlteaPharma 2013” sh.p.k.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

13.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administratorit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruanjë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë ortakut te vetem per miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmes atjeve të shoqërisë, që kërcënoinjë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

13.2 Administratori i therret Ortakët, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajive në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojoj në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë,
- shoqëria propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë.

13.3 Nëse ortakët, emërojnë më shumë se një administrator, ata e administratorinë bashkëkërisht shoqërinë. Ortakët mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.Padtë, që lidhen me shpërbirimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontrakte me shoqërimë, irregulllohen sipas dispozitive ligjore në fuqi.

Neni 14

Shpërbëria dhe likuidimi

- 14.1 Shoqeria mbaron me vendim te Ortakëve ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet e parashikuara ne ligji.

Neni 15
Viti Financiar

5

- 15.1** Viti finansiar i Shoqërisë fillon 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.
15.2 Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 16
Kontrolli Financiar

- 16.1** Kontrolli finansiar I Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjisacionit shqiptar në fuqi.

Neni 17
Bilanci Vjetor

- 17.1** Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrative mbi ecurinë e veprimitari sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Ortakët e shoqërisë.
Shoqeria eshte e detyruar te dorezoje bilancin brenda afateve te caktuara ne ligjin mbi kontabilitetin.

Neni 18
Perfaqësimi

- 18.1** Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtoshen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.
18.2 Administratori, që përfaqëson shoqërinë tregtare, mund të autorizojë persona te tjere për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
18.3 Njoftimet e drejtuara se cilët administrator janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
18.4 Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI
Prishja dhe njoftimet

Neni 19
Prishja dhe likuidimi

- 19.1** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur imbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer vepрimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I vepрimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - e) me vendim të gjykatës;
- 19.2** Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapijen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 dei në 203 të Ligjit 9901.
- 19.3** Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me Nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 20
Njoftimet

folosej 6

- 20.1 Njoffimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftej për këtë qëllim dhe personin që kryen njoffimin.
- 20.2 Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratori në faqen e internetit të shoqërise).

Neni 21

Punesimet ne Shoqeri

- 21.1 Per punonjesit qe do te punesohen, marredheniet juridike midis shoqise dhe te punesuarve do te regullohen me kontraten e punes ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.

Neni 22

- 22.1 Shoqeria merr persiper te derdh irregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit.

Neni 23

Gjuha

- 23.1 Ky Akt Themelimi u nënshkrua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 24

Zgjidhja e mosmarveshieve


- 24.1 Te gjithe mosmarveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit, do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

Neni 25

Dispozita përfundimtare

- 25.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt themelimi dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008 "Per tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut


Lefter Ndrio